

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Vrasja e Ramadan Mataj në Shkodër, një nga vëllezërit pranohet krimin. Ujë e ftohtë, krahë të vdekur, martesa lidhe me motrinë tënde, ka prishur dy vrasës të dyshuar

2

Babai/ Spërmartori shqiptar vritet me një puntë në vendin e punës, policia arreston bashkëdashetarin si

3

Magjia apo Kalcumi? Cili është më i vështirë për kocka të forta

4

Detaje të reja nga vrasja e Matajit në Shkodër: Gjykatësit e kësaj lidhe intime me motren e autenti! I ru rrefen si inskenoi elektoratin

5

Miratshet 'Paketa e Maleve' / Kriteret për shpërbim me 1.5 të takës shpërbimorë 500 subvete që investojnë përjashtohen nga 4 taksa për 10 vite

Kronikë

Tiranë, vajza mbyllet në apartamentin e katit të 8-të në Astir, telefonon policinë se u dhunua! RENE A hyn me litar nga dritarja! Në banesën ngjitur gjejnë armë e kokainë (VIDEO)

Telefonata e një vajze në polici, rreth orës 14:00 se ishte dhunuar nga disa persona alarmoi policinë e cila blindo për mbi 1 orë zonën e Astirit në Tiranë, pasi dëshonte se mos ishim para një rasti rrëmbimi. Policia hyri me litar nga tarraca në dritaren e katit të 8-të, gjen vajzën në gjëndje të rëndë psikologjike. **Detaje çfarë ndodhi.** Babai pretendoi se u rrëmbye!



Sokol Dema

9 Janar, 13:35 | Përditësimi: 9 Janar, 16:56

f

Share


A A

TIRANË - Telefonata e një vajze në sallën operative, rreth orës 14:00 (9 janar 2025) se ishte dhunuar nga disa persona alarmoi policinë e cila blindo për mbi 1 orë zonën e Astirit në Tiranë, pasi dëshonte se mos ishim para një rasti rrëmbimi.

Çfarë ka ndodhur?

Gjithçka ka nisur përpara se vajza të telefononte policinë. Efektivët kishin pasur dyshime për armë në një apartament në zonën e Astirit e kanë shkuar për kontroll. Apartamenti figuronte përballë apartamentit ku ndodhej vajza. Kur efektivët kanë trokitur në banesën ku dyshohej se kishte armë, vajza e cila ndodhej në apartamentin përballë ka filluar të bërtasë dhe është kyçur brenda në gjëndje të rënduar psikologjike. Pa ditur për aksionin e policisë tek apartamenti tjetër ka telefonuar sallën operative për të kërkuar ndihmë. Kur policia ka shkuar atje, ka refuzuar të hapë derën.

'Shtetasja S.Q. ka njoftuar sallën operative se ndodhet në një banesë në katin e 8-të, dhe pretendon se është dhunuar nga disa persona. Menjeherë në vendngjarje kanë mbërritur shërbimet e Policisë, Grupi Hetimor, shërbimet zjarrëfikëse dhe po punojnë për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes si dhe ofrimin e ndihmës së qytetares. Shërbimet e Policisë po negociojnë me shtetasen S.Q, pasi e ka mbyllur derën dhe nuk pranon ta hap' informoi fillimisht policia e Tiranës.



[Sh]
LEXO EDHE:
Tiranë/ 47-vjeçari i futet së resë në banesë, tenton ta ngacmojë! 3 të tjerë dhunojnë nënën e partneret! Vihen në pranga

Nga frika se mos vajza po tentonte të kryente një akt që mund të dëmtonte veten e vet, forcat RENE A kanë ndërhyrë për të hyrë në apartament me litar duke zbritur nga tarraca. Siç u pa edhe nga pamjet e siguruar nga Report Tv, dy efektivë të forcave speciale, u lidhën me litar dhe u hodhën nga tarraca e pallatit dhe zbritën në katin e tetë, ku futën nga dritarja dhe ballkoni.

Vajza e identifikuar si S.Q., është gjetur në gjëndje të rënduar psikologjike, por pa shenja dhune.

Rreth orës 14:10, u bë hapja e derës së banesës nga Forcat "Renea", nuk pati probleme. Shtetasja S.Q, ndodhet nën asistencën e stafit mjekësor. Nga këqyrja paraprake nuk konstatohen shenja të dukshme fizike.

Në banesën përballë apartamentit ku u gjet vajza janë gjetur dy armë mbetje të lëndëve narkotike dhe ka qenë thaujse e shkatërruar.

Gjatë kryerjes së veprimeve të ngutshme hetimore dhe kontrollit të apartamenteve të tjera në pallatin në fjalë, në një banesë tjetër janë gjetur 2 armë zjarri pistoletë. Brenda kësaj banese nuk janë gjetur persona në momentin e kontrollit. Grupi hetimor po kryen veprimet përkatëse me qëllim zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e poseduesit të armëve.

Siç bën me dije gazetari Sokol Dema, të dy apartamentet ishin marrë me qira nga i dashuri i vajzës dhe policia është në kërkim të tij, ndërkohë babai i vajzës pretendon se djali ka marrë vajzën me zor dhe e ka mbajtur peng.

Dyshimet e policisë janë se brenda apartamentit tjetër kanë qenë dhe disa djem. Po verifikohet se kush janë këta djemtë.

G.K/S.G/Shqiptarja.com

TAG: [Tirane](#) [astir](#)

Komento

Komente

Iris:	10/01/2025 04:22
Tingellon si veprim për te zhvendurur policine! Ndersa policia shpetonte vajzen /e zallsur/kriminelet nga ana tjetere e pallatitja mbatnin ne drejtim te paditur.	
Përgjigju	
B.D:	09/01/2025 17:07
Vajti të shpëtoj vajzën e rrëmbyer dhe ajo vajza e shpëtoj policin se ngeli var në litar, shqyrr që nuk ishin rrëmbysit aty se polici do ishte varros nesër. Made in China equipment.	
Përgjigju	
miri:	09/01/2025 15:36
pune police, ju renea une jam brisku tani	
Përgjigju	

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A duhet të çojë SPAK Berishën përpara Gjykatës për masakrën e 21 janarit?

10 Janar, 11:51

Po

Jo

Nuk e di

Lajme të tjera

- Tiranë/ Mbante armë zjarri dhe municion luftarak në banesë, arrestohet 71-vjeçari! I dënuar më parë në Gjermani për vrasje

11 Janar, 10:06
- Orë kritike për Kryepiskopin Anastas, besimtarët mblidhen mes lutjesh në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë (VIDEO+FOTO)

10 Janar, 21:56
- E reja alarmoi RENE A-n në Astir, sociologu: Edukata e rrugës po shkatërron personalitetin e fëmijëve tanë

10 Janar, 15:54
- Shpallet logoja fituese e Tirana Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025, Veliaj: Mbështesim më shumë artin dhe kulturën

10 Janar, 14:19
- Zyrtare/ Partizani prezanton sulmuesin e Kombëtares, firmos deri në vitin 2029

10 Janar, 12:49
- Zbardhet misteri i vajzës në 'Astir'! Halucinacione nga droga?! 5 djemtë me armë e kyçen në apartament të qetësohej, 21-vjeçarja njoftoi policinë

Sokol Dema

10 Janar, 10:49
- Zyrtare/ Alban Bushi firmos kontratën e re, drejton Kombëtaren U-21 deri në fund të vitit 2026

10 Janar, 10:46
- U ekstradua nga Turqia, Dritan Rexhepi kërkon të jetë prezent në gjyqin për rrëmbimin e zhdukjen e Jan Preqës! GJKKO i cakton 'arrest me burg'

10 Janar, 10:08
- Tiranë/ Mbante armë zjarri pa leje në mobilierinë e tij, arrestohet 51-vjeçari

10 Janar, 09:53
- Tiranë/ 69-vjeçari plagoset me mjet presës nga një 45-vjeçar, i moshuari goditi fillimisht me sende të forta

9 Janar, 22:05
- Majko paralajmëron përballje të fortë elektorale me kreun e PD, ish-kryeministri: Arsyet përse Berisha më sulmon

9 Janar, 20:51
- GJKKO dënon 2 gra për ushtrim të ndikimit të paligjshëm, por ua fal izolimin pas gjyqimit të shkurtuar (EMRAT)

9 Janar, 19:42